# ANEKSI 1

1. **DOKUMENTAT STANDARTE TË PROCEDURËS KONKURUESE PËR DHËNIEN ME KONÇESION TË DISA SHËRBIMEVE DETARE**

# ANEKSI 2

OFERTA E KONÇESIONARIT

(DOKUMENTAT E OFERTES SE PARAQITUR TE DATES 20.04.2017 NE MINISTRINE E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES)

Shtojca 1

# FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit: ANIJET E SHËRBIMIT DETAR SH.A

Për: *MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, Blv. "Dëshmoret e Kombit", Nr.2, Tiranë, Shqiperi.*

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat: Koncesion Shërbimi

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Financimi, rehabilitimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimit të së drejtës së operimit dhe pronësisë (forma ROT) e shërbimit të anijeve detare.

Publikimi : Buletini i Njoftimeve Publike Nr.12 datë 27 Mars 2017

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se oferta jonë është sipas kritereve si më poshtë:

| Nr | Kriteret | Njësia e matjes* | Oferta* | Referenca në dokumente |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Çmimi për çdo shërbim | EURO | EURO/orë | EURO/orë |
| | Anije | deri në 1000 GT | 100 | 150 |
| | | 1001-2000 GT | 200 | 200 |
| | | 2001-3000 GT | 350 | 350 |
| | | 3001-5000 GT | 500 | 500 |
| | | 5001-7000 GT | 600 | 600 |
| | | 7001-10000 GT | 760 | 760 |
| | | 10001-15000 GT | 950 | 950 |
| | | 15001-20000 GT | 1100 | 1100 |
| | | 20001-25000 GT | 1300 | 1300 |
| | | Mbi 25000 për çdo 1-5000 GT | 200 Euro shtesë mbi tarifen 1300 Euro | 200 Euro shtesë mbi tarifen 1300 Euro |
| 2 | Numri i rimorkiatoreve të ofruar | COPE | 11 | Dokumentacioni i rimorkiatoreve të ofruar referuar në dokumentet teknike në SPE |
| 3 | Koha e venies në shfrytëzim (muaj) | MUAJ | 1 | - |
| 4 | Ndikimi social dhe mjedisor | Nga analizat dhe konsideratat e vleresuara në raportin e ndikimit në mjedis të bërë nga ekspertë të fushës Anijet e Shërbimit Detar sha sjell impakte të dukshme pozitive në rajonet ku operon dhe mjedisin rreth tij. Shoqëria | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | angazhohet që në veprimtarinë e saj të ofrojë shërbime cilësore e të sigurta, duke aktivizuar gjithashtu forma të përshtatshme për të promovuar zhvillimin dhe rritjen e përgjegjësisë sociale të kompanisë. Të vetëdijshëm për rëndësinë e kësaj qasje ne promovojmë një stil pune që përqëndrohet jo vetem në realizimin e fitimit por njëherazi në arritjen e rezultateve të qëndrueshme të cilat krijojnë një impakt social të shëndoshë në shoqëri, komunitet, mjedis e kudo. Për më tepër në dokumentacionin "Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedisi" dhe "Profili i Kompanisë dhe ndikimi social në aktivitetin e saj kuadri i përgjegjësisë sociale" referuar në dokumentet e faktit në SPE. | | |
| 5 | Vlera "Fee Konçesionare" (e shprehur në % të të ardhurave vjetore nga shitja) | % | 2% | |
| 6 | Fuqia e rimorkiatoreve të ofruar | H/P | 19,689 | Dokumentacioni i fuqisë së rimorkiatorëve të ofruar referuar në dokumentet teknike në SPE |
| 7 | Vleresimi sipas formularit te përvojës në ujërat Shqiptare | Vite | 19 | Referuar në Shtojcën 7 dhe Kontratë Konçesionare |
| | | Anijet e Shërbimit Detar sha është një kompani me një përvojë të gjatë në ujërat Shqiptar, ajo u krijua si shoqëri aksionere me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.20430 datë 16.12.1998 ku u percaktua dhe forma e drejtimit. Që prej 19/03/2012 Anijet e Shërbimit Detar sha ka nënshkruar kontratë konçesionare 5-vjeçare me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës me objekt "Dhënia me Konçesion e disa Shërbimeve Detare", me vendodhje të objektit të kontratës në të gjitha portet e hapura të Republikës së Shqipërisë. | | |

Nënshkrimi i ofertuesit ____________

Vula

Më poshtë pasqyrohet tabloja aktuale dhe e ardhshme e mjeteve kryesore të cilat shërbejnë për shërbimin e dhënë me konçesion e ndare në:

- Mjetet e Kryesore ekzistuese me vlere neto **118.374.000** lekë
- Mjete kryesore të reja dhe investime meremetimi të mjeteve ekzistuese me vlere **120.000.000** lekë

Në varësi të këtyre vlerësimeve do të jepet edhe vlera e projektit për konçesionin me objekt "Disa Shërbime Detare"

## Preventivi i ofertës:

| Nr. | EMERTIMI | Vl. kont. Bruto | % Amortizimit | Amortizimi per v.2016 | Amortizuar deri 31/12/16 | Vl. NETO 31.XII.2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | R/M " Dyrrah" | 14,370,000 | 20% | 513,000 | 12,319,000 | 2,051,000 |
| 2 | R/M "Debatik" | 28,317,870 | 20% | 1,085,400 | 23,976,870 | 4,341,000 |
| 3 | R/M "Bregdeti" | 3,199,600 | 20% | 109,200 | 2,765,600 | 434,000 |
| 4 | R/M "Iliria" | 52,741,178 | 20% | 3,039,602 | 40,587,178 | 12,154,000 |
| 5 | R/M "Teuta" | 43,682,100 | 20% | 2,138,000 | 35,132,100 | 8,550,000 |
| 6 | R/M "Aulona" | 43,682,100 | 20% | 2,138,000 | 35,132,100 | 8,550,000 |
| 7 | R/M "Epidamn" | 73,473,460 | 20% | 4,572,660 | 55,179,460 | 18,294,000 |
| 8 | R/M Arberia | 8,600,000 | 20% | 574,520 | 6,299,000 | 2,301,000 |
| 9 | R/M "Adriatik" | 98,420,000 | 20% | 11,355,800 | 52,995,000 | 45,425,000 |
| 10 | R/M " Iliria I " | 27,902,550 | 20% | 4,068,550 | 11,628,550 | 16,274,000 |
| | **S H U M A** | **394,388,858** | | **29,594,732** | **276,014,858** | **118,374,000** |
| 11 | Blerje R/M | 58,000,000 | 20% | | | 58,000,000 |
| 12 | Blerje R/M | 55,000,000 | 20% | | | 55,000,000 |
| 13 | Investime | 7,000,000 | 20% | | | 7,000,000 |
| | **Vlera e projektit** | **514,388,858** | | **29,594,732** | **276,014,858** | **238,374,000** |

Nga kjo pasqyre ka dalë edhe vlera e projektit prej **238.374.000** lekë.

# ANEKSI 3

# RREGULLORET PËR PËRDORIMIN E RIMORKIATORËVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

# RREGULLORE

**PËR PËRDORIMIN E RIMORKIATORËVE
NË PORTIN E "SARANDËS"
DHE PORTIN E "LIMIONIT"**

Nr. 3/7/1 Prot.                                        Durrës, më 02.09.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 34 prot. Durrës, më 02.5.2015

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 10 109, datë 02.04.2009 "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 47 datë datë 15.04.2013 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", si edhe shkresës së Minisitrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 1947/1 prot, datë 19.04.2011 për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, nxjerr këtë,

# RREGULLORE

## NENI 1

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE

1.1 Përdorimi i shërbimit të rimorkiatorëve në hyrje dhe dalje nga Porti i Sarandës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, është i detyrueshëm për të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë.

1.2 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Porti i Sarandës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën të gjitha anijet e transportit të ngarkuara me mallra të cilat në bazë të Konventës SOLAS dhe Kodit IMDG, klasifikohen si mallra të rrezikshme, pavarësisht nga gjatësia e tyre.

1.3 Përdorimi i shërbimit të një rimorkiatori është i detyrueshëm në hyrje dhe dalje nga porti i Sarandës dhe lëvizjet nga një kalatë në tjetrën për të gjithë anijet e transportit të mallrave me gjatësi nga 80 (tetëdhjetë) ml deri në 140 (njëqindedyzet) ml, pavarësisht nëse disponon paisje ndihmuese (bow thruster).

1.4 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrjes në Portin e Sarandë të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 150 ml (njëqindepesëdhjetë) e lartë.

1.5 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve të cilat akostohen me bord në kalatë, do të konsiderohen dhe trajtohen sipas rregullave të anijeve të transportit të mallrave, përcaktuar në këtë rregullore.

1.6 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrjes dhe daljes në Portin e Limionit të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë.

1.7 Përdorimi i rimorkiatorëve është i detyrueshëm edhe në të gjitha rastet specifike kur urdhëron Kapiteni i Portit.

## NENI 2

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË 2 (DY) RIMORKIATORËVE

2.1 Është i detyrueshëm shërbimi i 2 (dy) rimorkiatorëve gjatë hyrje-daljeve nga Porti i Sarandës për të gjitha anijet e mallrave me gjatësi 140 (njëqindedyzetë) e lartë ml.

## NENI 3

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE NË ASISTENCË

3.1 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë, të cilat akostohen me kiç në kalatë, janë të detyruar te përdorin shërbimin e 1 (një) rimorkiatorit në asistencë vetëm gjatë akostimit. Gjatë ç'akostimit, përdorimi i rimorkiatorit bëhet vetëm me kërkesën e kapitenit ose pilotit që ndodhet në bordin e anijes.

## NENI 4

### PËRDORIMI ME KËRKESË I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE

4.1 Të gjitha anijet e transportit nën 80 (tetëdhjetë) ml, gjatë hyrje-daljeve në portin e Sarandës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën kanë të drejtë të përdorin shërbimin e rimorkiatorëve me kërkesën e tyre.

4.2 Të gjitha anijet e transportit nën 80 (tetëdhjetë) ml, gjatë hyrje-daljeve në portin e Limionit kanë të drejtë të përdorin shërbimin e rimorkiatorëve me kërkesën e tyre.

4.3 Kërkesa për përdorimin e rimokiatorëve për anijet e tonazhit të mësipërm, bëhet vetëm nga Kapiteni i Anijes nëpërmjet Kapitenerisë së Portit.

4.4 Në të gjitha rastet kur Kapiteni i anijes kërkon shërbimin e një ose më shumë rimorkiatori, shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit është e detyruar ta mundësojë menjëherë atë.

## NENI 5

### ZBATIMI

5.1 Kjo Rregullore është e detyrueshme për zbatim nga shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit, kapitenët e anijeve, shoqëritë e pilotimit dhe Kapiteneria e Portit Sarandë.

5.2 Ngarkohet me kontrollin e zbatimit të këtij urdhëri Kapiteneria e Portit Sarandë.

## NENI 6

### HYRJA NË FUQI

6.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas daljes së saj.

6.2 Rregullorja e Drejtorisë së Përgjithshme Detare Nr. 317, datë 20.08.2015, shfuqizohet

6.3 Të gjitha aktet e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare që bien në kundërshtim me këtë Rregullore shfuqizohen.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

# RREGULLORE

## " PËR PËRDORIMIN E RIMORKIATORËVE NË PORTIN E DURRËSIT DHE ROMANO PORT "

Nr. 3141/2 Prot.

Durrës, më 02.09.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 37/1 prot. Durrës, më 02.5. 2015
/2

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 10 109, datë 02.04.2009 "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 47 datë datë 15.04.2013 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", si edhe shkresës së Minisitrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 1947/1 prot. datë 19.04.2011 për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, nxjerr këtë,

# RREGULLORE

## NENI 1

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE

1.1 Përdorimi i shërbimit të rimorkiatorëve në hyrje dhe dalje nga Porti i Durresit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, është i detyrueshëm për të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë.

1.2 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Porti i Durrësit dhe gjatë ~~manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën të gjitha~~ anijet e transportit të ngarkuara me mallra të cilat në bazë të Konventës "SOLAS" dhe Kodit "IMDG", klasifikohen si mallra të rrezikshme, pavarësisht nga gjatësia e tyre.

1.3 Përdorimi i shërbimit të një rimorkiatoriështe i detyrueshëm në hyrje dhe dalje nga porti i Durrësit dhe lëvizjet nga një kalatë në tjetrën për të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi nga 80 (tetëdhjetë) ml deri në 140 (njëqindedyzet) ml, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmese (bow thruster).

1.4 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrjes në Portin i Durrësit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 180 (njëqindetetëdhjetë) ml e lartë.

1.5 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve të cilat akostohen me bord në kalatë, do të konsiderohen dhe trajtohen sipas rregullave të anijeve të transportit të mallrave, përcaktuar në këtë rregullore.

1.6 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën në portin "Romano Port" sh.a, të gjitha anijet tankera që transportojnë naftë ose produkte të saj si dhe gaz të lëngshëm.

1.7 Përdorimi i rimorkiatorëve është i detyrueshëm edhe në të gjitha rastet specifike kur urdhëron Kapiteni i Portit.

## NENI 2

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I 2 (DY) RIMORKIATORËVE

2.1 Të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 140 (njëqindedyzetë) ml e lartë, janë të detyruara të përdorin shërbimin e 2 rimorkiatorëve në hyrje dhe dalje nga porti i Durrësit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

2.2 Është i detyrueshëm shërbimi i 2 (dy) rimorkiatorëve gjatë hyrjeve dhe daljeve dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën në portin "Romano Port" sha, për të gjitha anijet tanker me gjatësi 130 (njëqindetridhjetë) ml e lartë, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

## NENI 3

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE NË ASISTENCË

3.1 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë, të cilat akostohen me kiç në kalatë, janë të detyruar te përdorin shërbimin e 1 (një) rimorkiatori në asistencë vetëm gjatë akostimit. Gjatë ç'akostimit, përdorimi i rimorkiatorit bëhet vetëm me kërkesën e kapitenit të anijes ose pilotit që ndodhet në bordin e anijes.

## NENI 4

### PËRDORIMI ME KËRKESË I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE

4.1 Të gjitha anijet e transportit nën 80 (tetëdhjetë) ml. gjatë hyrje-daljeve në portin e Durrësit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën kanë të drejtë të përdorin shërbimin e rimorkiatorëve me kërkesën e tyre.

4.2 Kërkesa për përdorimin e rimokiatorëve për anijet e tonazhit të mësipërm. bëhet vetëm nga Kapitenit i Anijes nëpërmjet Kapitenerisë së Portit.

4.3 Në të gjitha rastet kur Kapiteni i anijes kërkon shërbimin e një ose më shumë rimorkiatori, shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit është e detyruar ta mundësojë menjëherë atë.

## NENI 5

### ZBATIMI

5.1 Kjo Rregullore është e detyrueshme për zbatim nga shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit. kapitenët e anijeve. shoqëritë e pilotimit dhe Kapiteneria e Portit Durrës.

5.2 Ngarkohet me kontrollin e zbatimit të këtij urdhëri Kapiteneria e Portit Durrës.

## NENI 6

### HYRJA NË FUQI

6.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas daljes së saj.

6.2 Rregullorja e Drejtorisë së Përgjithshme Detare Nr. 314, datë 20.08.2015, shfuqizohet

6.3 Të gjitha aktet e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare që bien në kundërshtim me këtë Rregullore shfuqizohen.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

# RREGULLORE

**PËR PËRDORIMIN E RIMORKIATORËVE
NË PORTIN E "SHËNGJINIT"**

Nr. 315/2 Prot. Durrës, më 02.09.2015

RREGULLORE RIMORKIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr.___ prot. Durrës, më ___ . ___ 2015

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 10 109, datë 02.04.2009 "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 47 datë datë 15.04.2013 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", si edhe shkresës së Minisitrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 1947/1 prot, datë 19.04.2011 për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, nxjerr këtë,

# RREGULLORE

## NENI 1

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE

1.1 Përdorimi i shërbimit të rimorkiatorëve në hyrje dhe dalje nga Porti i Shëngjinit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, është i detyrueshëm për të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë.

1.2 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Porti i Shëngjinit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën të gjitha anijet e transportit të ngarkuara me mallra të cilat në bazë të Konventës SOLAS dhe Kodit IMDG, klasifikohen si mallra të rrezikshme, pavarësisht nga gjatësia e tyre.

1.3 Përdorimi i shërbimit të një rimorkiatori është i detyrueshëm në hyrje dhe dalje nga porti i Shëngjinit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën për të gjitha anijet e

transportit të mallrave me gjatësi nga 80 (tetëdhjetë) ml deri në 140 (njëqindedyzet) ml, pamvarësisht nëse disponon paisje ndihmuese (bow thruster).

1.4 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrjes në Portin e Shëngjinit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 130 (njëqindetridhjetë) ml e lartë.

1.5 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve të cilat akostohen me bord në kalatë, do të konsiderohen dhe trajtohen sipas rregullave të anijeve të transportit të mallrave, përcaktuar në këtë rregullore.

1.6 Përdorimi i rimorkiatorëve është i detyrueshëm edhe në të gjitha rastet specifike kur urdhëron Kapiteni i Portit.

NENI 2

**PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË 2 (DY) RIMORKIATORËVE**

2.1 Është i detyrueshëm shërbimi i 2 (dy) rimorkiatorëve gjatë hyrje-daljeve nga Porti i Shëngjinit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën për të gjitha anijet me gjatësi 140 ml (njëqindedyzetë) e lartë.

NENI 3

**PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE NË ASISTENCË**

3.1 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë, të cilat akostohen me kiç në kalatë, janë të detyruar te përdorin shërbimin e 1 (një) rimorkiatorit në asistencë vetëm gjatë akostimit. Gjatë ç'akostimit, përdorimi i rimorkiatorit bëhet vetëm me kërkesën e kapitenit ose pilotit që ndodhet në bordin e anijes.

NENI 4

**PËRDORIMI ME KËRKESË I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE**

4.1 Të gjitha anijet e transportit nën 80 (tetëdhjetë) ml. gjatë hyrje-daljeve në portin e Shëngjinit dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën kanë të drejtë të përdorin shërbimin e rimorkiatorëve me kërkesën e tyre.

4.2 Kërkesa për përdorimin e rimokiatorëve për anijet e tonazhit të mësipërm, bëhet vetëm nga Kapitenit i Anijes nëpërmjet Kapitenerisë së Portit.

4.3 Në të gjitha rastet kur Kapiteni i anijes kërkon shërbimin e një ose më shumë rimorkiatori, shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit është e detyruar ta mundësojë menjëherë atë.

## NENI 5

### ZBATIMI

5.1 Kjo Rregullore është e detyrueshme për zbatim nga shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit, kapitenët e anijeve, shoqëritë e pilotimit dhe Kapiteneria e Portit Shëngjin.

5.2 Ngarkohet me kontrollin e zbatimit të këtij urdhëri Kapiteneria e Portit Shëngjin.

## NENI 6

### HYRJA NË FUQI

6.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas daljes së saj.

6.2 Rregullorja e Drejtorisë së Përgjithshme Detare Nr. 315, datë 02.09.2015. shfuqizohet.

6.3 Të gjitha aktet e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare që bien në kundërshtim me këtë Rregullore shfuqizohen.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

# RREGULLORE

## PËR PËRDORIMIN E RIMORKIATORËVE NË PORTIN E "VLORËS", NË PORTIN "VLORA 1", NË SISTEMIN E BOVAVE TË "ARMO-s" NË SISTEMIN E BOVAVE "TEC"

Nr. 3/6/2 Prot.

Durrës, më 02.09.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. ___ prot. Durrës, më ___ 2015

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 10 109, datë 02.04.2009 "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 47 datë datë 15.04.2013 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", si edhe shkresës së Minisitrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 1947/1 prot, datë 19.04.2011 për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, nxjerr këtë.

# RREGULLORE

## NENI 1

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE

1.1 Përdorimi i shërbimit të rimorkiatorëve në hyrje dhe dalje nga Porti i Vlorës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, është i detyrueshëm për të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë.

1.2 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Porti i Vlorës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën të gjitha anijet e transportit të ngarkuara me mallra të cilat në bazë të Konventës "SOLAS" dhe Kodit "IMDG", klasifikohen si mallra të rrezikshme, pavarësisht nga gjatësia e tyre.

1.3 Përdorimi i shërbimit të një rimorkiatori ështe i detyrueshëm në hyrje dhe dalje nga porti i Vlorës dhe lëvizjet nga kalata për të gjithë anijet e transportit të mallrave me gjatësi nga 80 (tetëdhjetë) ml deri në 140 (njëqindedyzet) ml, pavarësisht nëse disponon paisje ndihmese (bow thruster).

1.4 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrjes në Portin e Vlorës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 150 (njëqindepesëdhjetë) ml e lartë.

1.5 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve të cilat akostohen me bord në kalatë, do të konsiderohen dhe trajtohen sipas rregullave të anijeve të transportit të mallrave, përcaktuar në këtë rregullore.

1.6 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Porti "Vlora 1" dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, të gjitha anijet tankera që transportojnë naftë ose produkte të saj si dhe gaz të lëngshëm.

1.7 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Sistemi i Bovave të "Armo-s", të gjitha anijet tankera që transportojnë naftë ose produkte të saj.

1.8 Janë të detyruara të përdorin rimorkiator gjatë hyrje-daljeve nga Sistemi i Bovave të "TEC-it", të gjitha anijet tankera që transportojnë naftë ose produkte të saj.

1.9 Përdorimi i rimorkiatorëve është i detyrueshëm edhe në të gjitha rastet specifike kur urdhëron Kapiteni i Portit.

## NENI 2

### PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË 2 (DY) RIMORKIATORËVE

2.1 Të gjitha anijet e transportit të mallrave me gjatësi 140 (njëqindedyzetë) ml e lartë, janë të detyruara të përdorin shërbimin e 2 (dy) rimorkiatorëve në hyrje dhe dalje nga porti i Vlorës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

2.2 Është i detyrueshëm shërbimi i 2 (dy) rimorkiatorëve gjatë hyrjeve dhe daljeve nga porti "Vlora 1" dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën, për të gjitha anijet tanker me gjatësi 130 (njëqindetridhjetë) ml e lartë, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

2.3 Është i detyrueshëm shërbimi i 2 (dy) rimorkiatorëve gjatë hyrjeve dhe daljeve nga Sistemi i Bovave të "Armo-s", për të gjitha anijet tanker me gjatësi 130 (njëqindetridhjetë) ml e lartë, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

2.4 Është i detyrueshëm shërbimi i 2 (dy) rimorkiatorëve gjatë hyrjeve dhe daljeve nga Sistemi i Bovave të "TEC- it", për të gjitha anijet tanker me gjatësi 130 (njëqindetridhjetë) e lartë, pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

NENI 3

**PËRDORIMI I DETYRUESHËM I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE NË ASISTENCË**

3.1 Të gjitha anijet e transportit të mjeteve dhe ose udhëtarëve me gjatësi 80 (tetëdhjetë) ml e lartë, të cilat akostohen me kiç në kalatë, janë të detyruar te përdorin shërbimin e 1 (një) rimorkiatorit në asistencë vetëm gjatë akostimit. Gjatë ç'akostimit, përdorimi i rimorkiatorit bëhet vetëm me kërkesën e kapitenit ose pilotit që ndodhet në bordin e anijes.

NENI 4

**PËRDORIMI ME KËRKESË I SHËRBIMIT TË RIMORKIATORËVE**

4.1 Të gjitha anijet e transportit me gjatësi deri në 80 (tetëdhjetë) ml. gjatë hyrje - daljeve në portin e Vlorës dhe gjatë manovrave kur lëvizin nga një kalatë në tjetrën kanë të drejtë të përdorin shërbimin e rimorkiatorëve me kërkesën e tyre.

4.2 Kërkesa për përdorimin e rimokiatorëve për anijet e tonazhit të mësipërm, bëhet vetëm nga Kapiteni i Anijes nëpërmjet Kapitenerisë së Portit.

4.3 Në të gjitha rastet kur Kapiteni i anijes kërkon shërbimin e një ose më shumë rimorkiatori, shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit është e detyruar ta mundësojë menjëherë atë.

NENI 5

**ZBATIMI**

5.1 Kjo Rregullore është e detyrueshme për zbatim nga shoqëria që kryen shërbimin e rimorkimit, kapitenët e anijeve, shoqëritë e pilotimit dhe Kapiteneria e Portit Vlorë.

5.2 Ngarkohet me kontrollin e zbatimit të këtij urdhëri Kapiteneria e Portit Vlorë.

NENI 6

HYRJA NË FUQI

6.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas daljes së saj.

6.2 Rregullorja e Drejtorisë së Përgjithshme Detare Nr. 316, datë 20.08.2015, shfuqizohet

6.3 Të gjitha aktet e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare që bien në kundërshtim me këtë Rregullore shfuqizohen.

# ANEKSI 4

# STANDARTET E SHËRBIMIT TË RIMORKIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

STANDARTET
E SHERBIMIT TE RIMORKIMIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

1. Sherbimi i Rimorkimit funksionon ne te gjitha portet e hapura te Republikes se Shqiperise ne perputhje me kontraten e Koncesionit Nr..........dt. ..........

2. Sherbimi i rimorkimit eshte nje faktor i rendesishem per sigurine e anijeve qe perpunohen ne keto porte dhe funksionon ne baze te rregulloreve te nxjerra nga DPD.

3. Numri i rimokiatoreve qe ndodhet ne cdo port eshte i percaktuar sipas kerkesave ne dokumentat standarte. Perkatesisht ne portin e Durresit dhe Romano Port duhen 4 R/M, ne portin e Vlores dhe Vlora 1 duhen 2 R/M dhe ne portin e Shengjinit duhet 1 R/M.Porti i Sarandes mbulohet nga koncesionari ne te gjitha rastet kur kerkohet ky lloj sherbimi.

4. Sherbimi i Rimorkimit ne portet e R.Shqiperise funksionon 24 ore ne cdo dite te vitit, duke patur kanalet e perhershme te komunikimit me stacionin e pilotimit dhe Kapitenerine e Portit perkates.

5. Kapiteneria e portit nepermjet salles se kontrollit njofton 1 ore perpara fillimit te manovres per sherbimin e rimorkimit kompanin e sherbimit te rimorkimit per venien ne gadishmeri te mjeteve.

6. Fillimi i levizjeve dhe veprimet e rimorkiatoreve per kryerjen e sherbimeve te tyre behet ne rakordim me stacionin e pilotimit nen mbikqyrjen e Kapitenerise se Portit perkates.

7. Gjate kohes se kryerjes se sherbimit kapiteni i rimorkiatorit bashkevepron me pilotin e anijes qe po i kryhet sherbimi nen mbikqyrjen e Kapitenerise.Ne perfundim te sherbimit i raportohet salles se kontrollit te Kapitenerise.

8. Per raste te paparashikuara (emergjente) ne rregulloret perkatese kapiteni i Rimorkiatorit rakordon veprimet me sallen e kontrollit te Kapitenerise se portit perkates.

9. Per te gjitha veprimet e percaktuara sa me siper, Kompania e Sherbimit te Rimorkimit bashkepunon me Kapitenerine dhe stacionin e Pilotit te Portit perkates, pronaret e anijeve, agjensite detare dhe grupet e tjera te interesit.

10. Ne rastet e aksiedenteve detare me pasoje humbjen e jetes se njerezve pervec kryerjes se operacioneve te shpetimit(salvage), Rimorikatori detar nepermjet Kapitenerise se Portit bashkepunon me Rojen Bregdetare per evakuimin e personave ne rrezik.

11. Pergjegjegjesite ligjore per demtimet e shkaktuara nga Rimorkiatori gjate kryerjes se sherbimit te rimorkimit dhe shpetimit zgjidhen nga vete kompania.

# ANEKSI 5

# TARIFAT E SHËRBIMEVE QË U KRYHEN ANIJEVE NË PORTET DETARE TREGTARE TË RSH

Tarifat për shërbimin e rimorkimit janë:

| | |
|---|---|
| Deri në 1000 GT | 150 Euro |
| 1001 – 2000 GT | 200 Euro |
| 2001 – 3000 GT | 350 Euro |
| 3001 – 5000 GT | 500 Euro |
| 5001 – 7000 GT | 600 Euro |
| 7001 – 10000 GT | 760 Euro |
| 10001 – 15000 GT | 950 Euro |
| 15001 – 20000 GT | 1100 Euro |
| 20001 – 25000 GT | 1300 Euro |

Mbi 25000 GT për çdo 5000 GT 200 Euro shtese mbi vleren 1300 Euro

Ofertat që do të përmbajnë tarifa më të larta se këto nuk të pranohen.

- Rimorkimi është i detyrueshëm për të gjitha anijet që transportojnë lëndë të rrezikshme e lubrifikante, gjithashtu dhe për anijet e tjera të mallrave dhe udhëtarëve me kapacitet mbi 1000 GT.
- Për rimorkimin e anijeve Ro-ro dhe të udhëtarëve aplikohet zbritje 20% të tarifës bazë.
- Për rimorkimin e anijeve të ngarkuara me mallra të rrezikshme dhe karburante aplikohet shtese 20% të tarifës bazë.
- Për rimorkimin e anijes pa ndihmën e makinerisë së saj aplikohet shtesë 50% të tarifës bazë.
- Kur anija lëviz nga një kalatë në tjetrën paguhet 100% e tarifës.
- Tarifa për vënien e rimorkiatorit në gatishmëri (asistencë) miratohet në masën 40% të tarifës bazë.
- Tarifat e përcaktuara në këtë urdhër janë për kohen kur shërbimet kryhen nga ora 07:00 deri ne 17:00. Kur shërbimet kryhen nga ora 17:00 deri në orën 07:00, ditëve të diela dhe festave zyrtare, aplikohet një shtesë prej 50% mbi tarifën bazë.
- Anijet që transportojnë lëndë të rrezikshme e karburante me gjatësi mbi 130 ml dhe anijet e mallrave me gjatësi mbi 140 ml e kanë të detyrueshëm shërbimin e dy Rimorkiatorëve gjatë hyrjeve dhe daljeve në porte pavarësisht nëse disponojnë paisje ndihmëse (bow thruster).

Shërbimi i rimorkimit llogaritet sipas kohës së punës së kryer në bazë të tarifave të miratuara "Për një orë punë ose pjesë të orës". Koha e punës llogaritet nga çasti i lëvizjes së

rimorkiatorit nga baza e nisjes dhe mbaron në momentin e kthimit të tij në bazë. çistern të mëdha më tonazh më të lartë se 20,000 Ton.

# ANEKSI 6

KONTRATË E LIDHUR MIDIS KONCESIONARIT DHE AGJENCIVE DETARE PËRFITUES TË SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA KONCESIONARI

## KONTRATE SHERBIMI

Lidhur ndermjet:

Shoqerise **"Anijet e Sherbimit Detar"** SH.A me seli qendrore ne Durres,regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr: 20430 date 16.12.1998 dhe regjistruar ne Zyren e Tatimeve Durres me NIPT J61825517G perfaqesuar nga Z.Bujar Hoti,Administrator

dhe

**Agjensise Detare** _______________ me seli ne __________,regjistruar ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin e Gjykates se Rrethit ________Nr.________Date_______dhe regjistruar ne Zyren e Tatimeve_______, me NIPT.______________Perfaqesuar nga ________________.

Kontrata lidhet sot me date ____/____/____

### BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;

Kodi Detar i Republikes se Shqiperise;

Kontrata Koncensionare lidhur ndermjet Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures dhe Anijeve te Sherbimit Detar sh.a "Per dhenien me koncension te disa sherbimeve detare"

### NENI 1

### Objekti i kontrates

Kjo kontrate ka per objekt ofrimin e sherbimeve nga "Anijet e Sherbimit Detar" Sh.a Durres, si me poshte:

**1.1.**Sherbimin e rimorkimit te anijeve gjate operacionit te futjes dhe daljes neper porte,akostimit dhe ç'akostimit ne kalatat e porteve;
**1.2.**Sherbimin e transportit te grupeve te praktikes se autoriteteve portuale gjate marrjes se praktikave te lira ne rada;
**1.3.**Transportimin e ekuipazheve te anijeve nga rada ne port dhe anasjelltas.

## NENI 2

## TARIFAT

2.1 Tarifat do te llogariten mbi bazen e urdherit te perbashket te Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures Nr ______ date __________ dhe Ministrise se Finanacave Nr ________ date __________ per "Tarifat e Sherbimit te rimorkimit qe u kryhen anijeve qe prekin portet detare tregtare te Republikes se Shqiperise " duke pranuar çdo ndryshim te mundshem qe mund te pesojne".

## NENI 3

## DETYRIMET

3.1. "Anijet e Sherbimit Detar" Sh.a detyrohet:

3.1.1. Te garantoje sherbim te panderprere ne cdo ore dhe ne cdo dite te vitit.

3.1.2. Te perpiloje faturen tatimore per sherbimet e kryera dhe ta dorezoje prane agjensise qe i kryhet ky sherbim.

3.1.3. Te marre masa per te garantuar sigurine ne mjetet me te cilat do te ushtroje aktivitetin dhe do te ushtroje Sherbimet.

3.2. Agjensia "______________________________" detyrohet:

3.2.1. Te sjelle njoftimin paraprak te mbrritjes dhe te dhenat e nevojshme te anijes,te njejta me ato qe dorezohen prane Kapitenerise se Portit.

3.2.2. Te likujdoje detyrimin brenda 5 (pese) diteve nga data e faturimit.

## NENI 4

## Te drejtat

4.1. "Anijet e Sherbimit Detar"Sh.a ka te drejte:

4.1.1. Te njoftoje me shkrim per nderprerjen e sherbimit deri ne likujdimin e plote te detyrimit Agjensise debitore dhe Kapitenerine e Portit per zbatimin e procedurave te instruksioneve te brendshme te Kapitenerise se Portit nese nuk plotesohet pika 3.2.2 e kesaj kontrate.

4.2. Agjensia "________________ " ka te drejte"

4.2.1. Te paraqese prane "Anijeve te Sherbimit Detar"Sh.a te gjitha pretendimet qe ka ne lidhje me sherbimin e ofruar.

**NENI 5**

**Kohezgjatja**

5.1 Kjo kontrate ka afat vlefshmerie per nje periudhe kohe nje vjecare dhe rinovohet automatikisht me te njejten periudhe dhe kushte nese Palet nuk njoftojne zgjidhjen e saj te pakten 15 dite para mbarimit te afatit per te cilin eshte lidhur.

**NENI 6**

**Kushte te pergjithshme**

6.1 Kjo kontrate hartohet dhe interpretohet nga Palet ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore te Republikes se Shqiperise.

6.1 Per gjithshka qe nuk eshte shprehur posacerisht ne kete kontrate i referohet dispozitave te legjislacionit detar dhe ne mungese te rregullimeve nga ky i fundit atij civil ne fuqi.

6.2 Mosmarrveshjet eventuale qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj kontrate do te zgjidhen me mirekuptim.Ne te kundert palet do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

Kjo kontrate eshte e formuluar ne dy kopje origjinale te cilat i jepen seciles pale.

**Per AGJENSINE DETARE**

**Per"ANIJET E SHERBIMIT DETAR"SH.A**

**Administrator**

**Z.Bujar HOTI**

# ANEKSI 7

SIGURIMI I KONTRATËS

SIGMA INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

**Nr. Serie/ Serial No**
**Dega/ Branch**
**Kodi/ Code:**

Koha e shtypjes :31.05.2017 10:54:36

## FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS
## Guaranty Certificate Performance Bond

0000254

| Ref / Ref Numer | | Data/ Date | 31.05.2017 |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| Për/ To | MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES , TIRANE |
| | (Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor / Name and address of Contracting Authority) |
| **Në emër të** In the name of | ANIJET E SHERBIMIT DETAR , L.1 RR TAULANTIA PALLATI FLY KATI 11 DURRES |
| | (Emri dhe adresa e ofertuesit te siguruar / Name and the address of the insured bidder) |
| **Procedura e prokurimit** (Procurement procedure) | PPP KONCENSION SHERBIMI |
| | (Referenca e dosjes percaktuar sipas autoritet kontraktor/ File reference according to contracting authority) |
| **Pershkrim i shkurter i kontrates** (Short description of the contract) | FINANCIMI,REHABILITIMI,OPERIMI,MIREMBAJTJA DHE TRANSFERIMI TE SE DREJTES SE OPERIM SHERBIMIT TE ANIJEVE DETARE |
| | (Lloji i procedures dhe objekti / Kind of procedure and the object) |
| **Publikimi (nese zbatohet)** Publication (if applicable) | Buletini i njoftimeve i njoftimeve publike Dt. 22.05.2017 Nr. 20 |

| |
|---|
| Duke iu referuar procedures se lartepermendur dhe me kusht qe /referring to the former procedure, and with the condition that to: |
| ANIJET E SHERBIMIT DETAR |
| (emri i ofertuesit te percaktuar fitues/ name of the bid winner) |

| | |
|---|---|
| **T'i jete akorduar kontrata, ne vertetojme se** Has been accorded the contract, we certify that | ANIJET E SHERBIMIT DETAR |
| | (emri i ofertuesit te percaktuar fitues/ name of the bid winner) |
| Eshte garantuar prane shoqerise se sigurimeve SigmaInteralbanian VIG sh.a me nje vlere prej: Has a guaranty at our company that has a value: | 23,837,400 Njëzetë e TreMilion e TetëQindë e Tridhjetë e ShtatëMijë e KatërQindë Lekë |
| | (monedha dhe vlera e shprehur ne fjale dhe ne shifra/ value and currency ) |
| Si kusht per sigurimin e ekzekuimit te kontrates qe do te nenshkruhet me/as a condition for the execution of the contract signed with: | MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES |
| | (emri i autoritetit kontraktor/ name of the contracting authority ) |
| Marrim persiper te transferojme ne llogarine We are liable to transfer at the account of | MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES |
| | (emri i autoritetit kontraktor / name of the contracting authority) |

Vleren e siguruar , brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga kerkesa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe kjo kerkese te permende mospermbushjen e kushteve te kontrates / the insured value within 15 (fifteen) days from your first written request, without giving any explanation, with the condition that this request mentions that the contract conditions are not met.

Ky sigurim eshte i vlefshem deri ne zbatimin e plote te kontrates/ this insurance is valid up to the contract execution:

| Nga data/ from | 24.05.2017 | Deri më / Up to | 30.09.2022 |
|---|---|---|---|

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERI SIGURIMESH
SIGMA INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP
DEGA DURRES 1

Siguruesi

MIMOZA BARDHI/ MIMOZA BARDHI-069

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI AKSIONARE"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) | J61825517G | | | |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/01/1992 | | | |
| 3. Emri i Subjektit | ANIJET E SHERBIMIT DETAR | | | |
| 4. Forma ligjore | Shoqëri Aksionare | | | |
| 5. Data e themelimit | 16/12/1998 | | | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 16/12/1998 Deri: | | | |
| 7. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri | Durres Durres DURRES Lagjja nr.1, Rruga Taulantia, Pallati Fly, kati 11 | | | |
| 8. Kapitali | 106.485.000,000 | | | |
| 9. Vlera e kapitalit të shlyer: | 106485000.0000 | | | |
| 10. Numri i aksioneve: | 106.485,000 | | | |
| 10.1 Vlera nominale: | 1.000,000 | | | |
| 11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë | të zakonshme | me përparësi | me të drejte vote | pa të drejte vote |
| 11.1 Numri për secilën kategori | | | | |
| 12. Objekti i aktivitetit: | Marrja e praktikave te anijeve ne mberritje (rade), transportimi i grupit te praktikes(autoritete portuale).Transportimi i ekuipazhit te anijeve, udhetareve nga rada ne port dhe anasjelltas.Kryerjen e sherbimeve brenda akuariumit te portit. Kryerja e sherbimit rimorkiator tr anijave si gjate akostimit- ç'akostimit ne porte edhe ne raste avarije (defekti ne det), e te tjera ne perputhje me konventat detare nderkombetare. Kryerja e sherbimit ngarkim - shkarkim te mallrave me peshe te rende deri 100 ton me ndihmen e | | | |

| | | |
|---|---|---|
| | vinxhit lundrues. Furnizimin me uje te embel te anijeve shqiptare e te huaja sipas kerkesave te tyre.Germimin (thellimin), mirembajtja e kanaleve hyrese akuariumeve, kalatave te porteve detare. Kryen sherbime polumbare per kontrollin e objekteve te nevojshme. Shoqeria mund te marre pjese ne ndermarrje apo shoqeri te tjera qe kane object te njejte ose te perafert me te sajin dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet tregtare,financiare me karakter te luajtshem e te paluajtshem ,te pranoje dhe te leshoje garanci per vete apo per te trete ,te marre kredi dhe te kryeje cdo operacion bankar ,conform legjislacionit ne fuqi.Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo ne valuta te tjera ,prane bankave shqiptare apo te huaja ,duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluara ne to ,konform legjislacionit ne fuqi .Shoqeria mund te punesoje me kohe te plote ose te pjesshme profesioniste te mirenjohur nga fusha te ndryshme , konform legjislacionit ne fuqi. | |
| 13. Sistemi i administrimit | ☐ me një nivel | ☒ me dy nivele |
| 14. Administratori/ët | Bujar Hoti | |
| 14.1 Afati i emërimit | Nga: 04/06/2014 | Deri: 04/06/2017 |
| 15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| 15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka). | Te gjitha kopetencat | |
| 16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës *(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)* | Sokol Hoti | |
| 16.1 Kryetar/anëtar | Anetar | |
| 16.2 Afati i emërimit | [illegible] | [illegible] |
| 17. Anëtar i Pavarur | Po | |
| 17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve | Jo | |
| 17.2 Kushtet e pjesëmarrjes | | |
| 18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| ~~19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës~~ *(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)* | ~~Ilirjan Feri~~ | |
| 19.1 Kryetar/anëtar | Anetar | |
| 19.2 Afati i emërimit | Nga: 04/06/2014 | Deri: 04/06/2017 |
| 20. Anëtar i Pavarur | Po | |
| 20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve | Jo | |
| 20.2 Kushtet e pjesëmarrjes | | |
| 21. Procedura e emërimit nëse ndryshon | | |

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | | |
|---|---|---|
| nga parashikimet ligjore. | | |
| 22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës *(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)* | Artur Duni | |
| 22.1 Kryetar/anëtar | Anetar | |
| 22.2 Afati i emërimit | Nga: 04/06/2014 | Deri: 04/06/2017 |
| 23. Anëtar i Pavarur | Po | |
| 23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve | Jo | |
| 23.2 Kushtet e pjesëmarrjes | | |
| 24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| 25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar | HYSEN BEKA | |
| 25.1 Afati i emërimit | Nga: 03/06/2014 | Deri: |
| 26. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar | Luan Gosnishti | |
| 26.1 Afati i emërimit | Nga: 03/06/2014 | Deri: |
| 27. Aksionarët | Eftimi Jorgji | |
| 27.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: | |
| 27.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 | |
| 28. Aksionarët | Edlira Tatazi | |
| 28.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 32.0000<br>Pa te drejte vote: | |
| 28.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 | |
| 29. Aksionarët | Eftali Gjika | |
| 29.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: | |
| 29.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 | |
| 30. Aksionarët | Mimoza Keneta | |
| 30.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 32.0000<br>Pa te drejte vote: | |
| 30.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 | |
| 31. Aksionarët | Bujar Hoti | |

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB Qendra Kombëtare e Biznesit National Business Center

| | |
|---|---|
| 31.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 42594.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 31.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 40,000 |
| 32. Aksionarët | Selime Dhaskali |
| 32.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 32.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 33. Aksionarët | Ilirjan Feri |
| 33.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 20462.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 33.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 19,216 |
| 34. Aksionarët | Qamil Dollani |
| 34.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 34.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 35. Aksionarët | Eduart Kaja |
| 35.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 33.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 35.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 |
| 36. Aksionarët | Vladimir Gjika |
| 36.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 36.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 37. Aksionarët | Çezarina Nikaj |
| 37.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | |
|---|---|
| 37.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 38. Aksionarët | Natasha Dollani |
| 38.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 38.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 39. Aksionarët | Arta Kaja |
| 39.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 32.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 39.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 |
| 40. Aksionarët | Bahtice Hoxha |
| 40.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 40.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 41. Aksionarët | Astrit Kazazi |
| 41.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 41.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 42. Aksionarët | Selim Hoxha |
| 42.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 42.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 43. Aksionarët | Vasil Rapi |
| 43.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 43.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |

| | |
|---|---|
| 44. Aksionarët | Kujtim Hoti |
| 44.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 42594.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 44.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 40,000 |
| 45. Aksionarët | Fatmir Keneta |
| 45.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 33.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 45.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 |
| 46. Aksionarët | Behije Kazazi |
| 46.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 32.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 46.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 |
| 47. Aksionarët | Anila Rapi |
| 47.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 32.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 47.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 |
| 48. Aksionarët | Petraq Tatazi |
| 48.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 33.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 48.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,030 |
| 49. Aksionarët | Luigj Nikaj |
| 49.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote: 48.0000<br>Pa te drejte vote: |
| 49.2 Përqindja e pjesëmarrjes | ,040 |
| 50. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Vlore Vlore VLORE Porti Detar<br>Lezhe Shengjin SHENGJIN Porti Detar |

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | |
|---|---|
| 51. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: ANIJET E SHERBIMIT DETAR<br>Telefon: 052/33711<br>Të Tjera: Ne ceshtjen me nr cn-409431 behet shenimi:depozitim i kontrates se shitjes se kuotave nr Rep748Kol 711/2dt.28.05.2010 Bashkim Kondo zoterues i 0.045% te aksioneve per efekt sistemi eshte hedhur 0.04% Eldishane Kondo zoteruese e 0.045% te kuotave per efekt sistemi eshte hedhur 0.04% |
| 52. Statusi: | Aktiv |

Datë: 24-05-2017

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)